Regjistri I Kërkesave/Ankesave SHTATOR 2026 ISHTI

Nr. Rendor	Data e kërkesës	Objekti I kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e Përfundimit të kërkesës	Tarifa
1	09.09.2026	Ankesa konsiston në: 1- pretendime per instalimin e tubacioneve te shkarkimit ne fasaden e prones private te kryera pa leje nga ana e subjektit pavaresisht eleminimit te rrjedhjes se ujit. 2- pretendime per shtesat anesore te kryera kohe me pare. 3-zhurmat (ndotje akustike) te elektromotorreve te sistemit te kondicionimit te vendosur ne fasade si dhe disa bombola (ne dukje pajisje te sistemit ftohes te frigorifereve). 4-zhurma si pasoje e muzikes. 5-pretendime per mungese te lejes se zhvillimit te aktivitetit ne taracen e objektit pavaresisht se taraca eshte prone private. 6-indinjaten lidhur me Lejen e Ndertimit te dhene vite me pare per ndertimin e objektit pasi sipas saj vite me pare ka qene lulishte.	17.09.2026	Referuar ankesës së regjistruar në adresën zyrtare të institucionit (info@ishti.gov.al), më datë 09.09.2026 , ju informojmë se: ISHTI ngriti grup pune për verifikimin e situatës, me inspektorë nga Drejtoria e Inspektimit të Pajisjeve nën Presion. Grupi i inspektimit u paraqit pranë subjektit tregtar Nga kontrolli i ushtruar rezultoi se subjekti disponon 3 (tri) bombola GLN, me kapacitet 25 kg secila, të pajisura me sensorë dhe pajisje bllokuese për ndërprerjen e rrjedhjes së gazit në rast konstatimi të rrjedhjeve. Bombolat janë të vendosura në ambient të jashtëm, të ajrosur mirë dhe rezultojnë brenda afatit të vlefshmërisë së kolaudimit. Gjithashtu subjekti disponon dokumentacionin e plotë tekniko-ligjor, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi. Në përfundim të verifikimit, nuk u konstatuan mangësi apo kushte që cënojnë sigurinë teknike lidhur me instalimin dhe përdorimin e bombolave të gazit.	E plotë	0
2	09.09.2026	Kam një ankesë lidhur me shqetësimet e vazhdueshme që shkakton kjo pikë karburanti në ambientet e banimit. Situata bëhet veçanërisht shqetësuese gjatë orareve të furnizimit të depozitave të karburantit. Kjo situatë është bërë e padurueshme dhe po ndikon drejtpërdrejt në cilësinë e jetesës së banorëve të objektit. Theksoj se i gjithë objekti është objekt banimi, ndërsa pika e karburantit ndodhet në katin përdhe, poshtë ballkoneve. Për këtë arsye, prania dhe funksionimi i kësaj pike karburanti përbën një shqetësim serioz për banorët, jo vetëm për shkak të erërave dhe ndotjes së ajrit, por edhe për shkak të pasigurisë që krijon prania e një aktiviteti të tillë pranë banesave. Kjo situatë po krijon pasiguri dhe shqetësim të vazhdueshëm për jetën, shëndetin dhe sigurinë e banorëve, ndaj kërkoj që ankesa të trajtohet me seriozitet dhe të kryhet një verifikim sa më shpejt të jetë e mundur.	14.09.2026	Në përgjigje të ankesës Tuaj dërguar me email , protokolluar me Tonën Nr. 7115 Prot., datë 09.09.2026, lidhur me ankesën Tuaj për stacionin e shitjes me pakicë të karburanteve ku citoni se pika e karburantit ndodhet në katin përdhe, poshtë ballkoneve dhe se prania e funksionimi i kësaj pike karburanti përbën një shqetësim serioz për banorët, jo vetëm për shkak të erërave dhe ndotjes së ajrit po edhe për shkak të pasigurisë që krijon prania e një aktiviteti të tillë pranë banesave, ju informojmë si më poshtë. Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI) është organ i specializuar për kontrollin e veprimtarisë të personave juridikë në fushën hidrokarbure, ushtron kontrolle në të gjitha subjektet në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 99/2024 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”; ligjit nr. 8450 datë 24.02.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", të ndryshuar; Ligjit nr 32/2016, datë 24.03.2016 “Për garantimin e sigurisë së punës së pajisjeve dhe instalimeve nën presion”, si dhe aktet nënligjore që rrjedhin prej tyre. Në vijim të ankesës Tuaj dhe në zbatim të ligjit nr. 99/2024 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë, Inspektorët e ISHTI me datë 10.09.2026 të pajisur me Autorizim Inspektimi kanë inspektuar stacionin e shitjes me pakicë të karburanteve Inspektimi është kryer online me: 1.Listë Verifimi 2.Procesverbal Inspektimi 3.Vendimi Përfundimtar i Inspektimit Nga inspektim i mbajtur rezulton se ky stacion shitje me pakicë të karburanteve është pajisur me dokumentacionin tekniko – ligjor të cilat janë ngarkuar në sistem	E plotë	0

3	10.09.2026	Në cilësine e banorëve, qytetarëve dhe taksapaguesve te ketij komuniteti, bazuar ne te drejten tone legjitime kushtetuese per nje mjedis jetese te sigurt, te shendetshem dhe te paprekshem, po ju drejtohemi zyrtarisht me kete kerkese me karakter urgjent dhe emergjent, per shkak te nje paligjshmerie flagrante dhe te rrezikshme qe po konsumohet ne hapesiren tone publike. Ne territorin e parkut rekreativ te lagjes sone, i cili eshte i destinuar ekskluzivisht nga plani rregullues i Bashkise per shlodhjen e banoreve dhe argetimin e femijeve, eshte kryer nje nderhyrje e paligjshme me rrezikshmeri te la rte teknologjike dhe kimike. Konkretisht, nga subjekti ka uzurpuar nje siperfaqe e konsiderueshme publike permes vendosjes se nje depozite gazi apo lende tjeter plasese. Ky instalim nuk disponon asnje tabele treguese te autorizimit, lejes ndertimore, lejes mjedisore apo certifikimit te sigurise teknike nga MZSH. Per me teper, objekti permban lende me rrezikshmeri te la rte shperthimi dhe djegieje, te futur nentoke prane hyrjes se pallatit ku ne banojme. Ne mes te nje zone ku luajne femije dhe te rritur □do dite dhe e destinuar si park rekreativ nga Bashkia Tirane. Ne perputhje me detyrimet tuaja ligjore per mbrojtjen e rendit, jetes se qytetareve dhe prones publike, kerkojme nga ana juaj: Konstatimin e menjehershem ne terren te ketij uzurpimi permes strukturave tlnspektoriatit te Mbrojtjes se Territorit (IMT/IKMT) dhe Policise Bashkiake brenda 24 oreve.2.Hartimin e Procesverbalit te Pezullimit/Prishjes dhe marrjen e masave urgjente administrative per sekuestrimin, □montimin dhe largimin e menjehershem te depozites dhe lendeve te rrezikshme nga parku. 3.Kthimin e plote te hapesires publike ne gjendjen e meparshme, duke garantuar sigurine teknike te plote te territorit perreth. 4.Percjelljen e rastit prane Organ it te Prokurorise nga ana e Policise se Shtetit per ndjekje penale te autoreve, nese subjekti nuk largon depoziten dhe kthen lulishten ne gjendjen e meparshme bazuar ne Nenet 292 dhe 289 te Kodit .	10.09.2026	Në përgjigje të shkresës tuaj ardhur pranë ISHTIT me nr Prot 712, datë 10.09.2026, në lidhje me pretendimin tuaj për uzurpimin flagrant të pronës publike, cënim të rëndë të sigurisë dhe kërkesë për ndërhyrje ekzekutive të menjëhershme për eleiminimin e burimit të rrzikut, ju bëjmë me dije se: Nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial u krye inspektim në këtë subjekt me datë 10.09.2026 ku u konstatua se subjekti kishte në përdorim pajisje nën presion, specifikisht një rezervuar gazi (GLN) 1000 litra , i cili përdorej për gatim.Për këtë rezervuar subjekti në zbatim të Ligjit Nr.32 , datë 24.03.2016 "Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve nën presion , dispononte dokumentacion si më poshtë: Projekti Tenokoligj i instalimit të pajisjeve /instaliemve nën presion është hartuar nga Ing me licensë. Certifikata e Konformitetit e Vërtetimin e Përputhmërisë.të Projektit Teknik të Pajisjeve të Përputhmërisë. të Projektit Teknik të Pajisjeve /Instalimeve nën Presion , është ktyer nga OMI Akti Teknik i Montitmit është lëshuar nga OMI Akt Teknik i Montimit është lëshuar nga shpk Pajisjet / Instalimet nën Presion ishin të pajisura me Deklaratën CE të Konformitetit. Ndodhur në keto kushte ju informojmë se subjekti i është lënë detyrë për plotësim dokumnetacioni : Certifikatat e Inspektimit të Konformitetit: Dëshmi e aftësisë Profesionale :Kontrata e Sigurimit të Përgjejgjësisë Civile. Për plotësim të dokumentacionit do të kryhet pas 8 ditësh si dhe do t'ju bëjmë me dije për rezultatet dhe masat e mëtejshme. Për sa më sipër , ISHTI nuk është Institucioni përgjegjegjës për kontrollin mbi zaptimin apo bllokimin të hapësirave publike apo të përbashkëta, por ISHTI është institucioni që ndjek dhe kontrollon sigurinë e instalimit dhe shfrytezimit si dhe dokumentacionit tekniko-ligjor të instalimeve të GLN	E plotë	0
4	10.09.2026	Inspektori i Policise Bashkiake ka marre ankese nga komuniteti për verifikimin e dokumentacionit dhe ligjshmërisë së pikës së një karburantit . Subjekti i ankesës ka paraqitur dokumentacionin përkatës, i cili është administruar nga ana jonë. Duke qenë se verifikimi i plotë i ligjshmërisë, dokumentacionit teknik, metrologjik dhe fiskal të pikave të karburantit nuk hyn në kompetencat e Policisë Bashkiake, por është detyrë e institucioneve të specializuara, këtë çështje e përcjellim për kompetencë ISHT-it.	18.09.2026	Në përgjigje të email-it ardhur në adresën: info@ishti.gov.al ku Inspektori i Policisë bashkiake ka marrë ankesë nga komuniteti për verifikimin e dokumentacionit dhe ligjshmërisë së pikës së karburanti në Tiranë ju informojmë si më poshtë: Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI) është organ i specializuar për kontrollin e veprimtarisë të personave juridikë në fushën hidrokarbure, ushtron kontrolle në të gjitha subjektet në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 99/2024 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”; ligjit nr. 8450 datë 24.02.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", të ndryshuar; Ligjit nr 32/2016, datë 24.03.2016 “Për garantimin e sigurisë së punës së pajisjeve dhe instalimeve nën presion”, si dhe aktet nënligjore që rrjedhin prej tyre. Në zbatim të ligjit nr. 99/2024 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë, Inspektorët e ISHTI me datë 10.09.2026 të pajisur me Autorizim Inspektimi kanë inspektuar stacionin e shitjes me pakicë të karburanteve Inspektimi është kryer online me: 1.Listë Verifimi 2.Procesverbal Inspektimi 3.Vendimi Përfundimtar i Inspektimit Nga inspektim i mbajtur rezulton se ky stacion shitje me pakicë të karburanteve është pajisur me dokumentacionin tekniko – ligjor të cilat janë ngarkuar në sistem: •Nga inspektimi i kryer rezulton se nuk ka shkelje të kërkesave ligjore. Lidhur me kërkesat fiskale, bëjmë me dije se kjo nuk përfshihet në detyrat ligjore të ISHTI	E plotë	0

5	14.09.2026	Jam një banor ku dua të denoncojë vendosjen e një depozitë gazi nga ana e një hoteli , duke marrë shkas edhe nga shpërthimi i gazit të karburantit dua të verifikohet sa më shpejt nga një trup inspektuese për sigurinë e banorëve.	15.09.2026	Në përgjigje të ankesës tuaj, regjistruar pranë Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial me nr. 7260 Prot., datë 14.09.2026, lidhur me dyshimin për vendosjen e një rezervuari gazi në ambientet e nje subjektit, ju bëjmë me dije se shqetësimi i paraqitur prej jush, është marrë në shqyrtim nga strukturat përgjegjëse të institucionit dhe është reaguar nga ana jonë në mënyrë të menjëhershme duke hapur inspektim. Në mbështetje të Ligjin 99/2024, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë" dhe Ligjit 32/2016 "Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve nën presion", do të vijohet me procedurën administrative të inspektimit online, nëpërmjet sistemit unik elektronik "e-inspektimi". Procedura do të ketë për objekt verifikimin e pretendimeve të ngritura në ankesën tuaj dhe respektimit të kërkesave ligjore për sigurinë e pajisjeve dhe instalimeve nën presion. Në përfundim të procedurës së inspektimit, do të informoheni mbi rezultatet përfundimtare të inspektimit, në përputhje me afatet dhe procedurat e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.	E plotë	0
6	17.09.2026	Të nderuar drejtues dhe përfaqësues të institucioneve, Po ju drejtohem me anë të këtij emaili në cilësinë e qytetarit dhe konsumatorit për të denoncuar rritjen e pajustifikuar dhe spekulative të çmimeve të karburanteve në tregun vendas. Siç dokumentohet edhe në foton bashkëlidhur këtij emaili, pranë pikës së shitjes me pakicë, çmimet e afishuara janë: Diesel extra: 219 Lek/Litër Unleaded 95 (Benzinë): 209 Lek/Litër Autogas (Gaz): 66 Lek/Litër Duke marrë parasysh ecurinë e çmimit të naftës në bursat ndërkombëtare dhe nivelin e taksave vendase, ky nivel çmimi përbën një barrë të rëndë dhe të papërballueshme për qytetarët, duke ngritur dyshime të forta për marzhe abuzive fitimi dhe mungesë të konkurrencës reale në treg. Përmes kësaj shkrese, kërkoj nga ana juaj: 1. Autoriteti i Konkurrencës: Të nisë një hetim të thelluar mbi mekanizmin e caktimit të këtyre çmimeve dhe të verifikojë nëse ka praktika të bashkërenduara apo marrëveshje të ndaluara mes operatorëve të tregut. 2. ISHTI dhe MFE: Të ushtrojnë kontrolle të rrepta mbi transparencën, faturimin dhe justifikimin ekonomik të këtyre tarifave ndaj konsumatorit fundor. Duke shpresuar në një reagim dhe marrje masash konkrete nga ana juaj, mbetem në pritje të konfirmimit për regjistrimin e kësaj ankese.	17.09.2026	Në përgjigje të kërkesës tuaj me e-mail, ku denonconi rritjen e pajustifikuar dhe spekulative të çmimeve të karburanteve në tregun vendas ju informojmë: Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI) është organ i specializuar për kontrollin e veprimtarisë të personave juridikë në fushën hidrokarbure, ushtron kontrolle në të gjitha subjektet në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 99/2024 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë"; ligjit nr. 8450 datë 24.02.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", të ndryshuar; Ligjit nr 32/2016, datë 24.03.2016 "Për garantimin e sigurisë së punës së pajisjeve dhe instalimeve nën presion"; Ligjit nr. 8734, datë 01.02.2001 "Për garantimin e sigurisë se punës te pajisjeve dhe instalimeve elektrike" i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore që rrjedhin prej tyre. Lidhur me kërkesën Tuaj mbi rritjen e pajustifikuar dhe spekulative të çmimeve të karburanteve në tregun vendas, bëjmë me dije se kjo nuk përfshihet në detyrat ligjore të ISHTI.	E plotë	0

7	17.09.2026	Ju drejtohem me shqetësimin serioz lidhur me sigurinë e godinës së banimit ku jetojmë dhe të të gjithë banorëve të saj. Poshtë godinës së banimit ndodhet një karburant i cili, për shkak të pozicionimit dhe afërsisë së tij me një objekt rezidencial, ngre shqetësime të rëndësishme për sigurinë e banorëve dhe përputhshmërinë me kërkesat ligjore dhe teknike për funksionimin e një aktiviteti të tillë. Duke pasur parasysh natyrën e aktivitetit të karburantit dhe rrezikun potencial që mund të paraqesë në rast zjarri, shpërthimi apo incidenti tjetër, konsiderojmë të domosdoshme që institucionet kompetente të kryejnë një verifikim të plotë dhe të menjëhershëm të situatës. Kërkojmë që të verifikohet, ndër të tjera: Nëse karburanti është i pajisur me të gjitha lejet dhe autorizimet e nevojshme; Nëse venddodhja dhe distanca nga godina e banimit janë në përputhje me kushtet dhe standardet e sigurisë; Nëse janë respektuar kërkesat teknike dhe të mbrojtjes nga zjarri; Nëse janë kryer kontrollet dhe inspektimet përkatëse nga institucionet kompetente; Nëse ekzistojnë masa të mjaftueshme për mbrojtjen e jetës dhe pronës së banorëve në rast incidenti. Duke qenë se bëhet fjalë për një aktivitet me rrezik potencial të lartë në një zonë banimi, kërkojmë që kjo çështje të trajtohet me prioritet dhe të ndërmerren masat e nevojshme nëse konstatohet se aktiviteti nuk përmbush kushtet ligjore dhe të sigurisë. Ju lutemi të na informoni me shkrim mbi rezultatet e verifikimit dhe masat që do të ndërmerren nga institucionet përgjegjëse. Siguria e banorëve dhe veçanërisht e fëmijëve që jetojnë në këtë godinë nuk duhet të lihet në rrezik për shkak të funksionimit të një aktiviteti të tillë.	21.09.2026	Në përgjigje të ankesës Tuaj dërguar me e-mail me datë , protokolluar me Tonën Nr. 7416 Prot., datë 17.09.2026, lidhur me stacionin e shitjes me pakicë të karburanteve i cili për shkak të pozicionimit dhe afërsisë së tij me një objekt rezidencial, ngre shqetësime të rëndësishme për sigurinë e banorëve dhe përputhshmërinë me kërkesat ligjore dhe teknike për funksionimin e një aktiviteti të tillë, ju informojmë si më poshtë. Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI) është organ i specializuar për kontrollin e veprimtarisë të personave juridikë në fushën hidrokarbure, ushtron kontrolle në të gjitha subjektet në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 99/2024 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë"; ligjit nr. 8450 datë 24.02.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", të ndryshuar; Ligjit nr 32/2016, datë 24.03.2016 "Për garantimin e sigurisë së punës së pajisjeve dhe instalimeve nën presion", si dhe aktet nënligjore që rrjedhin prej tyre. 1.Lidhur me ankesën Tuaj ku konsideroni të domosdoshëm që institucionet kompetente të kryejnë një verifim të plotë dhe të menjëhershëm të situatës ju bëjmë me dije se në zbatim të ligjit nr. 99/2024 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë, Inspektorët e ISHTI me datë 10.09.2026 të pajisur me Autorizim Inspektimi Nr. ISHTI-DQ-2026-005222 – 1, datë 10/09/2026, kanë inspektuar stacionin e shitjes me pakicë të karburanteve Inspektimi është kryer online me:•Listë Verifimi •Procesverbal Inspektimi •Vendimi Përfundimtar i Inspektimit Nga inspektim i mbajtur rezulton se ky stacion shitje me pakicë të karburanteve është pajisur me dokumentacionin tekniko – ligjor të cilat janë ngarkuar në sistem:•Kontratë Qiraje •Projekt Teknologjik Autogaz në pikën e karburantit •Vërtetim i përputhshmërisë së projektit teknik pajisjet/instalimet nën presion •Çertifikatë Kualifikimi •Çertifikatë konformiteti e inspektimit të rezervuarit të GLN •Vërtetim (për matje vëllimi rezervuari) •Akt Montimi/Instalimi i pajisjes nën presion •Çertifikatë për sigurinë ndaj zjarrit datë 09.02.2024•Projekti i Hyrjeve dhe Daljeve Karburanti •Formular Aplikimi në Bashkinë Tiranë për pajisje me autorizim për përdorimin e hyrjeve dhe degëzimeve egzistuese ose të	E plotë	0
8	17.09.2026	Bazuar në ankesën e banorëve ku në katin e parë ushtron aktivitetin pretendohet se është vendosur një rezervuar gazi ku bëhet rrezik për banorët që jetojnë në pallat dhe në këtë zonë.Për sa më sipër, në përfundim të verfikimit, lutemi të na informoni nëse kjo depozitë/rezervuar është e pajisur me certfikimet dhe dokumentacionin përkatës, nëse është e regjistruar pranë instirrucionit tuaj, si dhe nëse plotëson kërkesat dhe kushtet teknike të sigurisë për përdorim.	21.09.2026	Në përgjigje të shkresës Nr.7266 Prot, datë 14.09.2026 ardhur pranë ISHTI me Nr.7408 Pot, datë 17.09.2026 ku pretendohet për vendosjen e një rezervuar gazi pranë kopshti që përbën rrezik për jetën e banorëve të pallatit n ju bëjmë me dije si më poshtë: Inspektorët e Inspektoriatit Shtetëror Teknik dhe Industrial u paraqitën pranë ambjenteve të Kopshtit dhe kryen Inspektim në zbatim të Ligjit Nr. 99/2024, datë 12.09.2024 "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë" dhe Ligjit Nr. 32, datë 24.03.2016, "Për Garantimin e Sigurisë së Punës së Paisjeve dhe Instalimeve nën Presion". Subjekti dispononte Rezervuar Gazi të Lëngëzuar të Naftës (GLN) nëntokësor. Nga inspektimi ju la detyrë nxjerrja jashtë pune e Rezervuarit GLN brenda një afati 15 ditor. Pas përfundimit të këtij afati do të mbyllet Inspektimi. Sa më sipër me mbylljen e Inspektimit do tju njoftojmë përsëri mbi proçedurën e mbajtur në zbatim të "Ligjit të Inspektimt," dhe Ligjit "Për Garantimin e Sigurisë së Punës së Paisjeve dhe Instalimeve nën Presion".	E plotë	0

9	17.09.2026	Po ju kontaktoj sepse ISHTI ka përgjegjësi të drejtpërdrejta për gazin, pajisjet nën presion dhe sistemet e gazifikimit. Para hyrjes në treg, duam të sqarojmë kërkesat teknike që prekin instalimin e dataloggerëve ATEX dhe sensorëve në impiante gazi. VERIBOX-MINI është dataloggeri ynë ATEX për Zona 1 me komunikim 4G LTE të integruar. Punon plotësisht me bateri për mbi 6 vjet me profil ditor ngarkese dhe mund të instalohet direkt pranë pikës së matjes pa furnizim të jashtëm. Për matësit ekzistues ofron hyrje pulsi dhe encoder; për konvertuesit e volumit lexon direkt në RS232/RS485/TTL. Mbështet, ndër të tjera, EK260/EK280, Corus/Evo+, TME-400, Elcor, MacBat, Flowsick dhe Instromet, si dhe sinjale analoge për presion ose temperaturë. NB IoT Box MINI është alternativa jonë ATEX Zona 1 me komunikim NB-IoT Cat-NB2 të integruar dhe pa gateway. Ka 4 hyrje digjitale, 3 hyrje analoge, 2 dalje digjitale, RS232/RS485/TTL dhe encoder SCR; me kushte të përshtatshme radio është projektuar për mbi 10 vjet funksionim me bateri dhe transmetim orar. Kjo e bën të përshtatshme edhe për monitorim presioni, niveli ose pika të vështira për t'u arritur. Për matjen inteligjente të konsumatorëve familjarë dhe pikave më të vogla të matjes ofrojmë gjithashtu NB IoT Box LITE: një zgjidhje kompakte, me bateri dhe komunikim NB-IoT të integruar, e projektuar për teleleximin automatik të matësve të gazit pa pasur nevojë për gateway ose infrastrukturë radio të dedikuar. Të dyja pajisjet mund të dërgojnë të dhënat në VERILOG Dashboard, ku profilet e ngarkesës, vlerat e matjes dhe alarmet paraqiten në një vend. Të dhënat mund të eksportohen për integrim të mëtejshëm, p.sh. CSV/XML ose përmes API-së Nëse kjo temë i përket një institucioni, operatori TSO/DSO, kompanie gazi ose kolegu tjetër, do t'ju isha mirënjohës për një orientim ose përcjellje të mesazhit. A mund të na tregoni departamentin, procedurën ose kontaktin e duhur për këtë temë?	25.09.2026	Në përgjigje të e-mailit tuaj, ardhur pranë Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial me Nr.7418 Prot, date 17.09.2026 lidhur me sqarimet për kërkesat teknike, që prekin instalimin e dataloggerëve ATEX dhe sensorëve në impjante gazi ju bëjmë me dije se: Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI) është organ i specializuar për kontrollin e veprimtarisë të personave juridikë në fushën hidrokarbure, ushtron kontrolle në të gjitha subjektet në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr.99/2024, datë 12.9.2024 "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë, Ligjit Nr. 102/2015 "Për Sektorin e Gazit Natyror" i ndryshuar, Ligjit Nr. 32 datë 24.03.2016, "Për garantimin e sigurisë së punës së paisjeve dhe instalimeve nën presion", VKM Nr.1062 datë 23.12.2015 "Për miratimin e rregullit teknik për paisjet dhe bashkësitë nën presion", Urdhërit të Ministrit Nr. 184 datë 05.07.2005 "Për miratimin e kushteve teknike dhe normave të projektimit për impiantet dhe instalimet që shërbejnë për transportimin, depozitimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre", Përsa më sipër, në vijim të komunikimit tuaj ju bëjmë me dije se kërkesa juaj për orientim lidhur me departamentin, procedurën apo institucionin përkatës për prezantim dhe integrimin e këtyre zgjidhjeve teknike, nuk përfshihen në kompetencat funksionale të Inspektoriatit Shtetëror Teknik dhe Industrial.	E plotë	0
10	18.09.2026	Me anë të kësaj shkrese, ju drejtohemi për të denoncuar dhe kërkuar verifikim e hetimadministrativ dhe, sipas rastit, penal, në lidhje me një çështje që lidhet drejtpërdrejt mesigurinë publike: procedurën aktuale të dhënies së certifikatave të përcaktimit të vëllimittë depozitave/rezervuarëve të naftës bruto, gazit dhe nënprodukteve të tyre,Kërkojmë që të verifikohen të gjitha certifikatat e përcaktimit të vëllimit të depozitave/rezervuarëve të lëshuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë gjatë periudhës nëtë cilën ka hyrë në fuqi procedura e re (pas shfuqizimit të Urdhrit 279/2017), meqëllimkonstatimin nëse për to është kryer apo jo matje fizike/volumetrike reale e vëllimit, aponëse certifikimi është bazuar thjesht në të dhënat e projektit të paraqitura nga subjektetaplikuese. 7. Kërkesa konkreteNë përfundim, i kërkojmë institucioneve të mësipërme: • Të kryejnë verifikim/hetim administrativ mbi ligjshmërinë e urdhrit të ri të DPM-sëdhe përputhshmërinë e tij me ligjin nr. 126/ 2020 "Për Metrologjinë"; • Të verifikojnë veprimtarinë e komisionit që hartoi ndryshimin e procedurës, • Të bëjnë auditimin e të gjitha certifikatave të vëllimit tëdepozitave/rezervuarëve të lëshuara që prej ndryshimit të procedurës; • Të vlerësojnë rrezikun real për sigurinë publike që paraqet certifikimi i depozitave/rezervuarëve pa matje fizike/ volumetrike të detyrueshme;	23.09.2026	Në përgjigje të ankesës Tuaj dërguar me email dhe protokolluar me Tonën Nr. 7477 Prot., datë 18.09.2026, kërkesë-denoncim "Mbi rrezikshmërinë e procedurës aktuale të verifikimit dhe çertifikimit të vëllimit të depozitave/rezervuarve të naftës bruto, gazit dhe nënprodukteve të tyre, pas shfuqizimit të Urdhrit nr. 279, datë 16.10.2017 dhe miratimit të urdhrit të ri nga Drejtoresha e Përgjithshme e Metrologjisë, ju informojmë si më poshtë. Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI) është organ i specializuar për kontrollin e veprimtarisë të personave juridikë në fushën hidrokarbure, ushtron kontrolle në të gjitha subjektet në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 99/2024 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë"; ligjit nr. 8450 datë 24.02.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", të ndryshuar; Ligjit nr 32/2016, datë 24.03.2016 "Për garantimin e sigurisë së punës së pajisjeve dhe instalimeve nën presion", si dhe aktet nënligjore që rrjedhin prej tyre. Procedura e lëshimit të Certifikatave të kalibrimit të vëllimit të depozitave/rezervuarve të naftës bruto, gazit dhe nënprodukteve të tyre kryhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë ose organet e autorizuara për këtë qëllim dhe nuk përfshihet në detyrat ligjore të ISHTI.	E plotë	0
11	22.09.2026	Duke ju falënderuar dhe një herë për punën tuaj ju lutem të vazhdoni të kryeni vërtetime dhe veprime të mëtejshme në funksion të dy pikave të mëposhtme: 1. Ka filluar dhe përfunduar ndërtimin e depozitës disa muaj para dhënies së lejës nga zyrat përkatëse në dhjetor të vitit 2025. Për të provuar këtë parregullsi jam i gatshëm t'ju dërgoj prova 2. Që struktura në fjalë bllokon një hapësirë publike me funksion jetik për pronat dhe banesat e fshatit ë. Për këtë mund të ballafaqoni hartat e pronësisë me vërtetime që edhe kryepleqësia edhe njësia administrative e fshatit janë të gatshme të japin për sa i përket funksionit të domosdoshëm dhe jetik të hapësirave të ulicave. Me mirënjohje dhe në gatishmëri për t'ju ndihmuar në punën tuaj të mëtejshme,	23.09.2026	Në vijim të komunikimeve të mëparshme dhe paraqitjes sërish të shqetësimit tuaj nëpërmjet të cilave jemi vënë në dijeni me të dhëna shtesë, lidhur me vendodhjen e depozitës, kohën e ndërtimit dhe hapësirën e zënë nga struktura në të cilën është e instaluar depozita e GLN-së, ju bëjmë me dije se: •Konstatimet e përcjella nga ana jonë janë të mbështetura në verifikimin e kryer në vend, dhe nga verifikimi i dokumentacionit tekniko-ligjor që shoqërojnë depozitën. •Shpjegimet ndaj murit të gurit dhe vendosjes së depozitës në oborrin e fqinjit tuaj, është bërë për të përshkruar saktë gjendjen faktike të konstatuar nga verifikimi dhe nuk përbën përcaktim të kufinjve të pronësisë mbi truallin përkatës. •Lidhur me pretendimin tuaj për zënien e hapësirës publike, tejkalimin e kufinjve të pronës etj, sqarojmë se verifikimi dhe përcaktimi i këtyre çështjeve nuk bëjnë pjesë në kompetencën funksionale dhe ligjore të ISHTI-t. •Pretendimet dhe provat që lidhen me pronësinë, zënien e hapësirës publike dhe ligjshmërinë e ndërtimit mund t'i drejtoheni institucioneve komptetente. Sa më sipër, rasti konsiderohet i verifikuar dhe i trajtuar nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial, brenda fushës së kompetencave të tij ligjore	E plotë	0

12	24.09.2026	Në Tiranë, pranë një shtylle të ndriçimit rrugor, lidhjet e përçuesve elektrikë ndodhen në një pusetë të hapur, në nivelin e trotuarit. Përçuesit dhe bashkimet janë të ekspozuara ndaj prekjes dhe ujit. Kjo gjendje krijon rrezik për kalimtarët, veçanërisht gjatë reshjeve. Kërkoj kontroll urgjent në vend, sigurimin e menjëhershëm të pikës së rrezikut dhe verifikimin e instalimit, përfshirë gjendjen e lidhjeve, tokëzimin e shtyllës dhe funksionimin e mbrojtjeve elektrike. Ju lutem të më njoftoni për konstatimet dhe masat e marra.	28.09.2026	Lidhur me ankesën tuaj administruar në ISHTI me Nr.7638 Prot , date 24.09.2026 lidhur me shtyllën e ndriçimit rrugor si dhe lidhjen e saj me rrjetin elektrik jashtë kushteve teknike për të cilën ISHTI i është drejtuar Bashkisë Tirane datë 28.09.2026, ku është kërkuar marrje masash të menjëhershme për heqjen e tensionit nëse ka, segmenti që është konstatuar shkelje, për sjelljen në konformitet të instalimit elektrik në përputhje me kërkesat e sigurisë elektrike, të ligjit Nr 8734, datë 01.02.2001, Për garantimin e sigurisë së Punës dhe të Pajisje dhe të Instalimeve Elektrike (i ndryshuar), i dhe te njoftohet ISHT, për masat e marra dhe realizimin e tyre. Datë 29.09.2026 ankuesi konfirmoi me e-mail se është ndërhyrë për riparimin dhe se gjendja është sistemuar.	E plotë	0
13	24.09.2026	Ju shkruajme nga kompania me aktivitet ne fushen e grumbullimit, trajtimit dhe asgjesimit te mbetjeve te rrezikshme spitalore, Do te vleresonim ndihmen tuaj lidhur me periodicitetin e ricertifikimit te kabines elektrike te tensionit te mesem nga organet e akredituara te vleresimit te konformitetit, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi. Ju lutemi te na konfirmoni nese ricertifikimi duhet te kryhet cdo vit apo nje here ne tre vjet.	25.09.2026	Në vijim të kërkesës tuaj ju sqarojmë se në zbatim të ; •VKM Nr.482, dt.17.06.2020 "Për miratimin e rregullës teknike për kushtet teknike dhe garantimin e sigurisë së linjave elektrike me tension të lartë mbi 1 KV" •VKM Nr.483, dt.17.06.2020 "Për miratimin e rregullit teknik për kushtet teknike dhe garantimin e sigurisë së instalimeve elektrike të tensionit të lartë mbi 1 KV". Inspektimi periodik i instalimeve dhe linjave elektrike të tensionit të lartë bëhet të paktën një herë në çdo tre vjet. Inspektimi periodik kryhet nga organizma të miratuar të vlerësimit të konformitetit në fushën përkatëse (O M V K). Listën e Organeve të Miratuara të Vlerësimit të Konformitetit sipas fushave përkatëse të veprimtarisë të cilave mund ti drejtoheni, e gjeni të shpallur në faqen zyrtare të M.I.E https://www.infrastruktura.gov.al/siguria-teknike-dhe-mbikeqyrja-e-tregut/.	E plotë	0
14	25.09.2026	Në ndjekje të shkreses së ardhur me protokoll nga Njësia Administrative Nr. 3, për vendosjen e bombolave të gazit në lulishte duke krijuar shqetësim, u be verifikimi problematikes. Nga verifikimi në kete adrese rezulton se subjekti ka vendosur bombulën e gazit në lulishte. Ndaj subjektit u lëshua Akt-Konstatimi për paraqitjen e dokumentacionit apo lirim e hapsires publike, në mënyrë vullnetare. Nga rikontrolli ushtruar rezulton se nuk janë marrë masat sipas detyrave të lëna. Ndaj subjekti u vendos masë administrative për zënien e hapësirës publike. Nëpërmjet sallës se Drejtimit dhe Koordinimint u njoftua IMT-ja, PMNZ-ja dhe ISHTI, për verifikimin dhe ndjekje të problematikës, sipas kompetencave ligjore.	25.09.2026	Inspektorati Shtetëror Tenik dhe Industrial, ka kryer inspektim në këtë subjekt më datë 18.09.2026, në zbatim të Ligjit Nr.99, datë 12.09.2024 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë" u verifikua i gjithë dokumentacioni për pajisjen nën presion, specifikisht Rezervuar Gazi (Gln) 1000 litra, i cili përdorej për gatim. Për këtë Rezervuar subjekti në zbatim të Ligjin Nr.32, datë 24.03.2016 "Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve nën presion", disponon dokumentacionin si më poshtë: •Projekti Teknologjik i instalimit të pajisjeve/instalimeve nën presion, me liçensë •Çertifikata e Konformitetit e Vërtetimit të Përputhshmërisë të Projektit Teknik të Pajisjeve/Instalimeve nën Presion, •Akti Teknik i Montimit lëshuar nga OMI •Pajisjet/Instalimet nën Presion ishin të pajisura me Deklaraten CE të Konformitetit. •Çertifikatat e Inspektimit të Konformitetit, është kryer nga OMI •Dëshmi e Aftësisë Profesionale, kryer nga OMI •Kontrata e Sigurimit të Përgjegjësisë Civile, Ndodhur në këto kushte ju informojmë se subjekti ka plotësuar të gjithë dokumentacionin tekniko-ligjor të parashikuar në Ligjin Nr.32, datë 24.03.2016 "Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve nën presion". Përsa më sipër, ISHTI nuk është Institucioni përgjegjës për kontrollin mbi zaptimin apo bllokimin të hapësirave publike apo të përbashkëta, por ISHTI është Institucioni që ndjek dhe kontrollon sigurinë e instalimit dhe shfrytëzimit si dhe dokumentacionit tekniko-ligjor të instalime të GLN	E plotë	0

15	28.09.2026	Në vijim të verifikimit të kryer nga ISHTI lidhur me situatën pranë Kabinës Elektrike si dhe në vijim të shkresës së ISHTI-së nr. 6196 prot., datë 03.08.2026, drejtuar OSHEE-së po ju drejtohem për një informacion zyrtar lidhur me zbatimin e masave të kërkuara. Në shkresën e sipërcituar, ISHTI ka kërkuar marrjen e masave në përputhje me kërkesat teknike dhe të sigurisë të përcaktuara në legjislacionin përkatës, përfshirë Ligjin nr. 61/2020 dhe VKM nr. 483, datë 17.06.2020. Për këtë arsye, ju lutem të më informoni: 1. Nëse OSHEE ka përcjellë pranë ISHTI-së përgjigje zyrtare lidhur me masat e marra në zbatim të shkresës nr. 6196 prot., datë 03.08.2026. Nëse një përgjigje e tillë, procesverbal, relacion, dokument teknik, fotografi apo dokument tjetër është administruar nga ISHTI, ju lutem të ma përcillni edhe mua një kopje, pasi jam kërkuesi i çështjes dhe personi drejtpërdrejt i prekur nga kjo situatë. 2. Nëse OSHEE nuk ka përcjellë përgjigje zyrtare, ju lutem të ma konfirmoni këtë me shkrim dhe të më informoni nëse ISHTI ka ndërmarrë ose do të ndërmarrë veprime të mëtejshme për zbatimin e masave të kërkuara. 3. Ju vë në dijeni edhe për dy zhvillime të reja në terren: - Ka ndodhur një zjarr pranë kabinës elektrike. Gjatë kësaj ngjarjeje kam ndërhyrë edhe vetë me ujë dhe zorrë për të ndihmuar në shuarjen e zjarrit. Për këtë ngjarje disponoj video, të cilën po jua bashkëngjis. - Më datë 19.09.2026, gjeneratori që ndodhej në hapësirën e aksesit është hequr me vinç dhe më pas është vendosur një gjenerator tjetër në të njëjtën hapësirë. Për këtë situatë është njoftuar edhe Policia dhe disponoj video të ngjarjes, të cilën po jua bashkëngjis. Këto materiale po jua përcjell për t'u administruar në dosjen e çështjes dhe për t'u vlerësuar nga ISHTI nga pikëpamja teknike dhe e sigurisë, veçanërisht në lidhje me masat e përcaktuara në shkresën nr. 6196. Theksoj se kërkesa ime nuk ka për qëllim ndërhyrjen në çështjen civile që është në shqyrtim gjyqësor, por vetëm verifikimin e respektimit të kërkesave teknike dhe të sigurisë për kabinën elektrike dhe të zbatimit të masave të kërkuara nga ISHTI ndaj institucioneve përgjegjëse. Duke qenë se kjo situatë vazhdon prej rreth tre vitesh dhe lidhet edhe me aksesin pranë një	02.10.2026	Në vijim të kërkesës tuaj administruar pranë I.SH.T.I-it Nr.7723 Prot datë 28.09.2026 sqarojmë sa më poshtë vijon ; Problemi juaj është trajtuar nga I.SH.T.I dhe drejtuar për zgjidhje instancave përkatëse me shkresën Nr 6196 prot datë 03.08.2026 (për dijeni edhe juve) të cilëve ju mund ti drejtoheni. Në çdo rast, është detyrimi i personit përgjegjës të produktit / instalimit të vënë në shërbim për të tretët apo për publikun, që instalimet elektrike të jenë në konformitet dhe në përputhje me kërkesat ligjore dhe nënligjore të shtetit Shqiptar në garantim të nivelit të duhur të sigurisë teknike	E plotë	0